VENDIM
Nr. 37, datë 16.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 145, DATË 20.2.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME PËRFAQËSUES NË SHTABIN 'EUFOR', NË KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK '*ALTHEA*', TË BASHKIMIT EVROPIAN, NË BOSNJË-HERCEGOVINË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 145, datë 20.2.2013, "Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me përfaqësues në shtabin 'EUFOR', në kuadër të operacionit ushtarak '*ALTHEA*', të Bashkimit Evropian, në Bosnjë-Hercegovinë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Dërgimin me mision në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, në kuadër të operacionit ushtarak "*ALTHEA*", të Bashkimit Evropian:

a) të 1 (një) përfaqësuesi ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në shtabin "EUFOR";

b) të 30 (tridhjetë) ushtarakëve në nivel "togë këmbësorie" nga Forca Tokësore e Republikës së Shqipërisë, në përbërje të kompanisë së pestë të manovrës së batalionit kinetik të Turqisë.".

2. Në pikën 2 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Fjala "... përfaqësuesi ..." zëvendësohet me "... përfaqësuesve ...";

b) Pas fjalëve "... aftësive mbrojtëse ..." shtohen "... si dhe garantimi i një mjedisi të sigurt për rritjen dhe forcimin e stabilitetit të shoqërisë në Bosnjë-Hercegovinë ...".

3. Në pikën 3, togfjalëshi "... deri në 26 shkurt 2025 ..." zëvendësohet me "... deri në 31 dhjetor 2028 ...".

4. Në pikën 4 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në fjalinë hyrëse, fjala "... përfaqësuesi ..." zëvendësohet me "... përfaqësuesit ...";

b) Në shkronjën "a", shifra 6000 (gjashtë mijë) zëvendësohet me 12 000 (dymbëdhjetë mijë);

c) Në shkronjën "e", pas fjalëve "... në rast ..." shtohen "... thyerje disipline ...".

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

III. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama